ZL.Anr.938/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Shpend Bilallit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i Shpend Bilallit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017.

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Shpend Bilallit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, me të cilën thekson se në vendvotimet : 1959/01D dhe 1933e/02R i mungojnë votat e familjarëve dhe po ashtu në formularët e rezultateve pretendon se janë bërë ndërhyrje në vota, andaj kërkon rinumërim të votave të saj në vendvotimet e lartcekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Shpend Bilallit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është i parregullt, sepse nuk është i nënshkruar nga parashtruesi i apelit dhe si i tillë apeli nuk i plotësonë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apeli apo në emër të tij nga personi i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartë theksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.938/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Zyhdi Haziri

Udhëzim Juridike:
PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*